

VENDIM
Nr. 627, datë 29.10.2025

**PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E
EKONOMISË MALORE NË BASHKINË BELSH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” në territorin e Bashkisë Belsh të disa zonave, si më poshtë vijon:

a) Zonës nr. 1, Njësia Administrative Belsh, fshati Qafëshkallë, me sipërfaqe 126.4 (njëqind e njëzet e gjashtë pikë katër) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

b) Zonës nr. 2, Njësia Administrative Belsh, fshati Gradishtë, me sipërfaqe 1.49 (një pikë dyzet e nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

c) Zonës nr. 3, Njësia Administrative Belsh, fshati Seferan-Hysë, me sipërfaqe 68 (gjashtëdhjetë e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

ç) Zonës nr. 4, Njësia Administrative Rrasë, fshati Shegas, me sipërfaqe 69.8 (gjashtëdhjetë e nëntë pikë tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto;

d) Zonës nr. 5, Njësia Administrative Fierzë, fshati Fierzë, me sipërfaqe 143.9 (njëqind e dyzet e tre pikë nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRRGJSH, të paraqitura mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese sipas sistemit KRRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këto zona janë:

a) të zhvillimit ekonomik;



b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.


4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Belsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



PLANVENDOSJE E ZONES ZHVILLIMORE (FIERZE)
SIPERFAQJA 143.9 Ha



REPUBLIKA E SHQIPËRIE



PROJEKTI
PLANVENDOSJE E ZONES ZHVILLIMORE

VEREDORIA
FIRMAT E PËRSHIRËS

SISTEMI KOORDINATIV
GJENDJEJA
RIL-02